

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

**PËRZGJEDHJA E TË RINJËVE TË MOSHËS 13 VJEÇE NË VRAPIMET
NË DISTANCA TË SHKURTËRA NË BAZË TË DISA AFTËSIVE
MOTORIKE BAZIKE DHE MOTORIKE SPECIFIKE**

MENTORI:

Prof.Dr. Naser Rashiti

KANDIDATI:

Florim Budakova

Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

1.HYRJE.....	3
2. QËLLIMI PUNIMIT.....	5
3. HIPOTEZAT THEMELORE.....	6
4.METODOLOGJIA E PUNËS.....	7
4.1 MOSTRA E TË TESTUARVE.....	7
4.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE.....	8
4.2.2 Variablat motorike bazike.....	9
4.2.3 Variablat motorike specifike	9
4.4 METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE.....	10
5. LITERATURA.....	11

1.HYRJE

Atletika është një nga llojet e sportit me karakter kompleks dhe aplikativ, i përberë nga grupe të mëdha, në të cilët përfshihen lloje të ndryshme atletikore, me karakteristika të ngjashme ndërmjet tyre. Atletika funksionon mbi bazën e një sistemi të caktuar të dijeve dhe të shprehive aplikative praktike, që ka në përmbajtjen e saj bazat teorike e metodologjike të mësim-dhënies dhe të stërvitjes sportive. Kështu, në disa vënde (Rusi,Itali etj), Atletika quhet “Atletikë e Lehtë” ; në Angli,ajo quhet “Track and field”, që do të thotë vrapim në fusha. Por nga kërkesat e larta në anën fizike , fiziologjike, lëvizore dhe psikologjike, në disa vende te Europës (në France ,Shqipëri), ky lloj sporti me të drejtë quhet Atletikë. Vrapimi është një lëvizje ciklike, nëpërmjet të cilit realizohet zhvendosja mbi truall nëpërmjet hapave. Ky ushtrim është i thjeshtë dhe mund të kryhet pothuajse nga të gjithë kategoritë e moshave. Vrapimi është një mjet bazë për përgatitjen fizike dhe zhvillimin e organizmit. Ai ndihmon për të përballuar ngarkesa stërvitore të larta. Vrapimi është mjet më universal për përgatitjen e gjithanshme të atletit, por ai zë një vend tepër të rëndësishëm edhe në stërvitjen e llojeve të tjera të sportit. Gjatë vrapimit , organizmit i paraqiten shumë kërkesa ndaj punës së sistemit muskolor dhe veprimtarisë vazokardiake dhe të frymëmarrjes. Ai përbën një mjet të rëndësishëm për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit.

Vrapimet zhvillohen në distanca dhe mënyra të ndryshme :

vrapimi i zakonshëm,vrapimi me pengesa,vrapimi me stafetë,vrapimi në natyrë.

Vrapimi i zakonshëm zhvillohet në pistën e stadiumit, por dhe në rrugë automobilistike apo në natyrë. Vrapimi i zakonshëm ndahet:

- Vrapime të shkurtra, ku bëjnë pjesë vrapimet e shpejtësisë (100,200 dhe 400 m) për meshkuj dhe femra. Këto vrapime përshkohen në pistën e stadiumit, ku secili atlet vrapon në korsinë e tij.
- Vrapime të mesme, ku përfshihen distancat 800-1500m, për meshkuj dhe femra. Këto distanca përshkohen në pistën e vrapimit në korsi të përbashkëta me përjashtim të vrapimit 800 m, ku 100 m e para përshkohen në korsi të vecanta.
- Vrapime të gjata ku përfshihen distancat 3000-5000m dhe 10 000 m.Këto distanca përshkohen në pistën e stadiumit, ku atletet vrapojnë në korsi të përbashkët.

Vrapimi është një mjet bazë për përgatitjen fizike dhe zhvillimin e organizmit. Ai ndihmon për të përballuar ngarkesa stërvitore të larta. Vrapimi është mjet më universal për përgatitjen e gjithanshme të atletit, por ai zë një vend tepër të rëndësishëm edhe në stërvitjen e llojeve të tjera të sportit. Gjatë vrapimit, organizmit i paraqiten shumë kërkesa ndaj punës së sistemit muskolor, veprimtarisë vazo kardiake dhe të frymëmarrjes. Ai përbën një mjet të rëndësishëm për ruajtjen dhe forcimin e shëndetit. Testet e shpejtësisë, të cilat masin aftësinë e organizmit për ekzekutim të lëvizjeve me shpejtësi maksimale e që në rastin tonë janë testuar me anë të vrapimeve 40 dhe 60 metra, paraqesin një tregues mjaftë të fuqishëm të nivelit të funksionimit të strukturave bartës të sistemit lokomotorë. Me anë të këtij punimi, do të bëhet përpjekje të identifikohet madhësia dhe roli i ndikimit që kanë dimensionet e koordinimit në manifestimin e rezultatit të vrapimeve në shtigje të shkurta të cilat do të testohen me anë të testeve vrapim 60 metra dhe vrapim 80 metra. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapësirë vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Me aplikimin e analizës faktoriale zbulohen gjithë e më shumë faktorë të cilët vërtetojnë ekzistimin e shumë faktorëve motorik siç janë: të forcës, shpejtësisë, koordinacionit, fleksibilitetit, dhe të tjerë që ka sjellur deri te pyetja se sa dimensione motorike objektivist ekzistojnë dhe çfarë është raporti ndërmjet tyre. Në bazë të hulumtimeve të cilat kanë pasur karakter taksonom në strukturën e hapësirës motorike (faktorë të rendit të parë) janë definuar faktorë të tipit akcional (forca, shpejtësia, fleksibiliteti, drejtpeshimi, koordinacioni dhe preciziteti) dhe faktorë të tipit topologjik (forca e matur me dinamometër, forca eksplozive, forca repetitive e duarve dhe e krahavorit, forca repetitive e këmbëve, forca repetitive e trupit, forca statike e duarve dhe e krahavorit, forca statike e këmbëve, forca statike e trupit, të vërejturit preciz, gjuajtja precize, drejtpeshimi me sy të mbyllur, drejtpeshimi me sy të hapur, fleksibiliteti, shpejtësia e lëvizjeve të thjeshta, shpejtësia e frekvencionit, shpejtësia e të mësuarit të detyrave të reja motorike, koordinimi në ritëm, agjiliteti, riorganizimi stereotip i lëvizjeve, shpejtësia e ekzekutimit të detyrave komplekse motorike, koordinimi i tërë trupit, koordinimi i duarve, koordinimi me këmbë. Zgjedhja dhe identifikimi i talentëve në sportin e atletikës dhe zhvillimi i tyre është një ndër komponentet e rëndësishme të programeve sportive esenciale në shumë shtete të zhvilluara. Në përcaktimin dhe formimin e tipareve antropologjike të një popullate të ndonjë shteti ndikim parësor kanë faktorët gjenetik, por nuk duhet lënë anash ndikimin e faktorëve të jashtëm, pra faktorët ekologjik ose të mjedisit.

Disiplinat individuale në atletikë janë aktivitete monostrukturale ciklike apo aciklike, që do të thotë se aktivitetet gjatë ekzekutimit mund të realizohen me veprimin e një sërë karakteristikash dhe aftësi antropologjike. Rezultatet të cilat i arrin një atlet gjatë garës varet nga faktorë të ndryshëm që ndikojnë në efikasitetin e tij (Trunić & Mladenović, 2014). Të gjithë faktorët nuk mund të ndikojnë në mënyrë të barabartë në rezultat, dhe as që mund të analizohen individualisht pa një lidhje adekuate me faktorë të tjerë. Nga ana tjetër, një faktorë nuk ka koeficientin e njëjtë të korrelacionit me faktorë të tjerë, por ndryshon.

Fakti se proceset e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve paraqesin procese mjaftë komplekse dinamike, të cilat vazhdimisht i nënshtrohen kombinimit të faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm, shtron nevojën e vërtetimit të ndikimeve të tretmanëve të caktuar lëvizore në rritje dhe zhvillim sa më harmonik. Mosha e përzgjedhur në hulumtim i takon fazës së pubertetit, ku më shumë se 90% e fëmijëve të kësaj moshe përjetojnë ndryshime strukturale dhe funksional si rezultat i veprimit të hormoneve të caktuara seksuale, të cilat afektojnë edhe zhvillimin e përgjithshëm trupor dhe intelektual dhe në masë të madhe ndikojnë edhe në manifestim të aftësive lëvizore. Vërtetimi i ndryshimeve në mes të grupmoshave 12, 13 dhe 14 vjeçare do të paraqes një tregues të dinamikës së lëvizjes progresive, në kuptimin e ngritjes së aftësive lëvizore.

Testet e shpejtësisë, të cilat masin aftësinë e organizmit për ekzekutim të lëvizjeve me shpejtësi maksimale e që në rastin tonë janë testuar me anë të vrapimeve 60 dhe 80 metra, paraqesin një tregues mjaftë të fuqishëm të nivelit, të funksionimit të strukturave bartëse të sistemit lokomotorë. Me anë të këtij punimi, do të bëhet përpjekje të identifikohet madhësia dhe roli i ndikimit që kanë dimensionin i koordinimit në manifestimin e rezultatit të vrapimeve në shtigje të shkurta të cilat do të testohen me anë të testeve vrapim 60 metra dhe vrapim 80 metra.

Koordinimi është aftësitë bazike motorike e cila për nga specifikat dallon në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me aftësi të tjera motorike . Besohet se koordinimit është aftësitë motorike më e hulumtuara deri më tani. Përkundër këtij fakti, me anë të treguesve të saj të tërthortë , faktorët e saj mund të tregojnë nivelin e zhvillimit të këtij dimensionit . Faktorët më të rëndësishëm të koordinimit janë : mosha, faktorët kognitive, përvoja e mëparshme lëvizore, gjendja emocionale , përqendrimi i vëmendjes dhe motivimi.

Ka përkufizime të ndryshme të koordinimit :

Zaciorski (1975) e përkufizon koordinimi si " aftësia për të përshtatur shpejt lëvizjen si kundërpërgjigje të ndryshimit rrethanave të jashtme".

Popmihajlovi (198) përcakton koordinimin si " aftësia për zotrimin e strukturave komplekse motorike, riorganizimin i atyre ekzistuese dhe aftësi e lartë e adaptimit në kushte të ndryshueshme ". " Koordinimi është aftësia për të përmbushur detyrat lëvizore që kërkojnë bashkëpunim të disa pjesëve të trupit , pa ndonjë përpjekje të lartë mendore dhe nivel të ultë të gabimeve me përpjekje minimale të individit" (Drabik , 1996) ." Koordinimi thjeshtë mund të përshkruhet si aftësia për të kryer lëvizje të thjeshta dhe komplekse , dmth . Aftësia për të kryer lëvizjet komplekse , por edhe të mësuarit e shpejtë e lëvizjeve të reja dhe aftësia e ndryshimet të shpejtë të një lëvizje me një lëvizje tjetër "(Drabik , 1996) " Koordinimi është aftësia për të kontrolluar lëvizjet e tërë trupit ose pjesëve të saj , dhe manifestohet me ekzekutimin e shpejtë dhe të saktë të detyrave motorike " (Mikic , 2000). Koordinimi është : aftësia për të kryer lëvizje të thjeshta dhe komplekse , të cilat janë të koordinuara në kohë dhe hapësirë , të cilat kryhen me përpjekje minimale , por është edhe aftësia për të kontrolluar lëvizjet e tërë trupit ose pjesëve të saj , dhe aftësia për të mësuar lëvizjet e reja dhe ndryshimet e shpejta të një lëvizjeje me njëri tjetrin.

Atletika, si një degë e sportit dhe si një sistem i lëvizjes, nuk mund të shikohet vetëm nëpërmjet rezultateve kulmore. Atletika ka një kuptim shumë më të gjerë si një degë e sportit, si dhe një mjet për edukimin fizik dhe mënyrën e jetesës të çdo njeriu të civilizuar. Secila nga disiplinat e atletikës vepron jo vetëm në zhvillimin e aftësive individuale, por edhe në statusin e përgjithshëm psikofizik të njeriut dhe për këtë arsye shpesh atletika quhet "mbretëresha e sportit".

"Mbretëresha e Sportit" gjithashtu ka karakteristikat e veta dalluese: lëvizjet sportive si ecja, vrapimi, kërcimi dhe hedhja përfaqësojnë lëvizjen natyrore, lëvizjen më të vjetër filogjenetike dhe ontogjenike të përdorur nga njeriu për të siguruar mbijetesën e tij dhe përshtetimin e zhvillimit të tij .

Ecja, vrapimi, kërcimi dhe hedhja, si një lëvizje e natyrshme, kanë një nivel të lartë të shërbimeve dhe si të tilla, ato janë baza për çdo aktivitet motorik të njeriut në përmbushjen e nevojat e tija të ndryshme.

Aktivitetet atletikore kanë një veçori të disponueshmërisë sepse ato mund të përdoren kudo, në hapësirat e lira, në rrugë, pyje, terene të hapura dhe të mbyllura, në stadione të projektuara posaçërisht, dhe me pajisje të veçanta.

Atletika ka saktësinë absolute të rezultateve, duke shmangur çdo mundësi të vlerësimit subjektiv të rezultateve të garës dhe çdo efekt mund të krahasohet objektivisht me të kaluarën ose rezultatet e arritura në vende të tjera ose nga atletë të tjerë.

Aktivitetet atletikore kanë një karakteristikë të gjithëpërfshirjes së pjesëmarrësve, sepse ato mund të përdoren nga fëmijët më të vegjël, studentët, atletët, rekreacionet më të reja dhe më të vjetra.

Atletika ofron një shans për specializime të ngushtuar dhe arritjen e rezultateve më të larta në 24 disiplina për meshkuj dhe 23 për femrat. Për kundër mundësisë për specializim të ngushtë të atletikës, atletika nuk e lë pas dore vlerën e promovimit të gjithanshmërisë, duke ruajtur traditën e lashtë të garave në disiplina të shumëgarshit, duke u dhënë individëve mundësinë për të demonstruar aftësinë e tyre për të pasur energji të larta të aftësive të ndryshme.

Njohuri ose aftësi atletikore janë baza apo themeli për përmirësimin afatgjatë për arritje të shumta individuale në pothuajse të gjitha sportet. Rezultatet mund të shërbejnë si një masë vlerësuese realiste e zhvillimit të aftësive njerëzore, të tilla si shpejtësia, qëndrueshmëria, forca dhe disa nga format e tyre.

Atletika ka një vlerë shumë arsimore edukative dhe është bazë për edukimin fizik të të rinjve të shkollave në shumicën e vendeve, si dhe tek ne. Për shkak të traditës, universalitetit, reputacionit, vlerave civilizuese-kulturore, ajo është bërë sinonim për të gjitha aspektet e vlerave të vërteta kulturore dhe të stilit civilizues të jetesës të të gjithë popujve të bashkësisë botërore.

Me angazhimin e përhershëm të ekspertëve dhe shkencëtarëve të atletikës, procesi i planifikimit dhe programimit të trajnimit në atletikë është hulumtuar gjerësisht dhe rezultatet janë zbatuar në praktikë. Por ende, për shkak të gjerësisë së aktiviteteve kineziologjike që

përbëjnë atletikën, si dhe faktin se atletika është e përhapur në të gjitha vendet, bota nuk ka modele të unifikuara të planifikimit dhe programimit në atletikë.

Disa vende janë të mëdha avokimi nga specialistët e tyre dhe shkencëtarët kanë ardhur në disa njohuri që kanë rezultuar dhe rezultojnë me rezultate kulmore të atletëve të tyre, dhe këto njohuri janë ruajtur me kujdes. Nëse pranojmë faktin se gjatë 15 viteve të fundit atletika është bërë një nga sportet më të folura që atletëve më të mirë dhe për këtë arsye edhe trajnerëve të tyre, u sjellin përfitime të mëdha është qartë se pse disa nga specifikat e trajnimit janë të fshehura nga publiku. Trajnimi i atletikës është një proces shumë kompleks që përfshin faktorët ekzogjenë dhe endogjenë, të përcaktuar nga cilësia dhe sasia, përvoja e atletëve garues etj.

Detyra kryesore e udhëheqjes së procesit stërvitor është përgatitja e një programi trajnimi.

Gjatë përgatitjes së trajnimit, duhet të përgjigjemi në dy pyetje: a) Si të planifikojmë ciklet e trajnimit? b) Cilat faktorë ndikojnë në përcaktimin e qëllimeve të disa cikleve të trajnimit.

Nelio Alfano Moura dhe Tania Fernandes de Paula Moura (2001): Duke përdorur modelin e planifikimit afatgjatë të trajnimeve, theksojnë se rezultatet më të mira të atletëve të disiplinave të shpejtësisë vijnë nga një qasje sistematike të proceseve stërvitore, me theks të veçantë në zhvillimin e forcës specifike.

Ata gjithashtu kanë paraqitur disa nga parimet më të rëndësishme në programet e trajnimit për këto disiplina: a) Duke preferuar ciklet më të shkurtra të trajnimeve dhe të gjata, në programin vjetor të trajnimit; b) Trajnimi specifik i forcës dhe shpejtësisë kryhet gjatë tërë sezonit sepse efektet e trajnimit janë absolutisht specifike; c) Cilësia e trajnimit është shumë më e rëndësishme se kuantiteti.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Kohëve të fundit është në rritje numri i punimeve nga autorë të ndryshëm në trajnimin e hapësirës së aftësive motorike në popullatën e të rinjve të moshave të ndryshme. Në trevat tona hulumtimet në popullatat e të rinjve, pavarësisht nga tretmani kineziologjik është ende i vogël, e në shumicën e hulumtimeve deri më tani kjo problematikë është trajtuar në mënyrë segmentare. Hulumtimet e kohës së fundit në hapësirën morfologjike flasin për ekzistimin e së paku katër dimensioneve latente: dimensionin i rritjes longitudinale të skeletit, dimensionin i rritjes transversale të skeletit, dimensionin i masës dhe vëllimit të trupit dhe dimensionin i indit dhjamor nënlëkuror të trupit. Hulumtimet në trevën tonë janë orientuar më tepër në fushat e morfologjisë dhe motorikes, ku kanë shqyrtuar strukturën faktoriale, lidhshmëritë dhe ndikimet e këtyre fushave me dukuritë e sporteve të ndryshme. Në shumë hulumtime të deritashme, në mostra të popullatës shkollore, është vërtetuar ekzistimi i dimensioneve antropometrike dhe motorike, por që ato ndryshojnë në varshmëri nga mostrat përkatëse. Në dy dekadat e fundit ekziston një numër relativisht i madh i eksperimenteve me nxënës të grupmoshave të ndryshme, sidomos të atyre prej 10 – 14 vjeç. Megjithatë, në bazë të literaturës që kanë shfrytëzuar, në vijim do të përshkruajmë disa hulumtime të cilat si objekt studimi kanë pasur vërtetimin e karakteristikave morfologjike dhe si dhe relacionet e tyre me aftësitë motorike të nxënësve në mostra përafërsisht të njëjta, me mostrën e këtij hulumtimi.:

Hirtz (1985) me koordinimin nënkupton : ekuilibër, ndjeshmëri për ritëm, orientimin hapësinor, ndjeshmëri kinetike dhe ngacmueshmëri në ngacmues vizuale dhe akustike .

Koordinimi është aftësia për drejtimin e lëvizjeve të tërë trupit apo pjesëve të sistemit lokomotorë, dhe dallohet me shpejtësi dhe precizitet të ekzekutimit të detyrave komplekse motorike , gjegjësisht me zgjedhjen e shpejtë të problemeve motorike.

Millovanović, (1997) Sipas Nicin (2000) me koordinimin si aftësi bazë motorike, nënkupton thelbin e lëvizjeve komplekse , ku me rastin e përvetësimit të këtyre lëvizjeve në masë dhe raport të caktuar marrin pjesë edhe aftësitë tjera motorike.

Skender (2002) në një mostër prej 160 të anketuarve 3 dhe klasën e 4 Shkolla fillore është përpjekur për të përcaktuar se çfarë lloj të efekteve mund të arrihet duke përdorur ushtrimet bazike motorike, aftësitë funksionale dhe karakteristikat morfologjike , me përdorimin e ushtrimeve të ndryshme nga atletika, gjimnastika dhe lojërat sportive . Për vlerësimin e aftësive motorike elementare (shpejtësi , koordinimit , fleksibilitet , të përsëritura dhe forca eksplozive) u aplikuan 21 variabla . Autori arrin në përfundimin se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në fushën e aftësive bazike motorike dhe aftësitë funksionale.

Metikoš et al (2003) përcaktojnë koordinimin psikomotorik si " koordinimin i cili zhvillohet me mësimin dhe shumëllojshmërinë e lëvizjeve të reja dhe me përsëritjen e ushtrimeve të mësuara më parë. Ushtrimet e koordinimit kërkojnë koncept më të lartë dhe në të ndikon një numër i madh i faktorëve. Përveç inteligjencës, stërvitjes sistematike dhe lëvizjeve të përvetësuara më herët në koordinim ndikon edhe niveli i aftësive tjera motorike. Niveli i lartë i shpejtësisë, forca, qëndrueshmëria dhe fleksibiliteti në mënyrë pozitive do të ndikojnë edhe në nivelin e koordinimit. Po ashtu edhe niveli i lartë i koordinimit ka transfero pozitive në aftësitë tjera motorike.

Volbekiene & Griciute (2007) kanë kryer një studim longitudinal në periudhën 1992-2002 vjet në një mostër prej 2,009 fëmijëve të Lituanisë. Qëllimi i hulumtimit ishte të analizojë dallimet në disa karakteristika antropometrike dhe aftësitë motorike në mes të djemve dhe vajzave të moshave 12, 14 dhe 16 vjet.

Volbekiene & Griciute (2007) kryen hulumtime të karakterit longitudinal në periudhën 1992-2002 në një mostër prej 2,009 fëmijëve të Lituanisë. Qëllimi i studimit ishte të analizonte dallimet në disa karakteristika antropometrike midis djemve dhe vajzave, të moshës 12, 14 dhe 16 vjeç. Në hapësirën e karakteristikave antropometrike, janë matur disa karakteristika morfologjike tek fëmijët, Rezultatet e arritura u vlerësuan duke përdorur analizën e variancës multivariate (MANOVA). Dallimet nuk ishin të rëndësishme në peshën e trupit, në indeksin e masës trupore (BMI indeksi i masës trupore) dhe në lartësinë e trupit.

Djuraskovic, Kostic, Pantelic, Zivkovic, Uzunović & Purenović (2009) kanë kryer një studim për të përcaktuar nëse ka dallime statistikore të mëdha në karakteristikat antropometrike mes djemve të rinj dhe vajzave të kësaj moshe nga Nishi.

Djuraskovic, Kostic, Pantelic, Zivkovic, Uzunović & Purenović (2009) ka kryer një studim për të përcaktuar nëse ka statistikisht dallime të mëdha në karakteristikat antropometrike mes djemve të rinj dhe vajza nga Nishi. Mostra përfshinte 176 nxënës të shkollave fillore, prej të cilëve 91 djem dhe 85 vajza. Në mostrën e instrumenteve matëse janë aplikuar 17 ndryshore antropometrike për matjen antropometrike, longitudinale, transversale, masën dhe volumenin trupor dhe indin dhjamor nënlëkuror të trupit, duke përfshirë edhe BMI. Dallimet në mes të matjeve antropometrike të djemve dhe vajzave u përcaktuan duke përdorur t-testin. Rezultatet e fituara nga t-test treguan se nuk kishte dallime të rëndësishme statistikore në matjet e karakteristikave antropometrike. Megjithatë, diferenca numerike në shumë parametra antropometrik mund të gjenden në mes të mostrave, si dhe dallimeve të mëdha brenda grupit që sinjalizojnë heterogjenitetin e grupeve sa i përket karakteristikave antropometrike. Ka dallime në vlerat mesatare numerike të matjet e hulumtuara ekzistojnë dhe vajzat ku treguan vlera më të larta në vëllimin e trupit dhe parametrat e indit të yndyrës nënlëkurore, të cilat mund të shpjegohen në bazë të karakteristikave gjinore.

Milanese, Bortolami, Bertucci, Verlato, & Zancanaro (2010) kanë kryer një studim për të vlerësuar marrëdhëniet e mundshme mes karakteristikave antropometrike dhe aftësitë motorike të fëmijët e moshës 6-12 vjeç.

Milanese, Bortolami, Bertucci, Verlato, & Zancanaro (2010) ka kryer një studim për të vlerësuar marrëdhëniet e mundshme mes karakteristikave antropometrike dhe aftësitë motorike me fëmijët e moshës 6-12 vjeç dhe marrëdhëniet e tyre. Mostra ka përfshirë 152 fëmijë të cilët iu nënshtruan matjet standarde antropometrike (BMI, perimetri bel, perimetri i kofshës, perimetrin e gjoksit, perimetri i krahut, dhe 5 matje të indit dhjamor nënlëkuror). Të anketuarit ishin të ndarë në bazë të moshës (6-7, 8-9, 10-12 vjet) dhe gjinisë (meshkuj dhe femra), dhe koeficient korrelacioni sipas Spearmanit është përdorur për të vlerësuar lidhjen mes BMI dhe masave të tjera antropometrike në çdo klasë, si dhe për korrelacion midis testeve antropometrike dhe aftësive motorike. Efekti i moshës, gjinisë, masave antropometrike dhe aftësive motorike është vlerësuar duke përdorur analizën e variancës multivariate (MANOVA). Bazuar në këto rezultate, mund të shihet se aftësitë motorike nuk janë të ndikuara nga indeksi i peshës trupore (BMI), ndërsa indi dhjamor nënlëkuror në korrelacion negativ me shpejtësinë të meshkujt mes moshës 6-7 vjet dhe kërcim së gjati të femrat moshat 8-12 vjet.

2. QËLLIMI PUNIMIT

Njeriu është i përbërë nga aftësi dhe tipare të ndryshme. Zhvillimi dhe niveli i arritur, si dhe marrëdhëniet e tyre, janë të ndryshme nga personi në person. Karakteristikat antropologjike përbëhen nga: karakteristikat antropometrike, aftësitë motorike dhe konjitive, karakteristikat konative dhe statusi shoqërorpër objektivizmin e treguesve të ndikimit të ushtrimeve fizike e sidomos të vrapimeve në distanca 60 dhe 100 metra, që në mënyrë të sigurt dhe efikase mundë të diagnostifikojmë, programojmë, që në mënyrë direke të udhëheqim dhe kontrollojmë proceset transformuese.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që duke aplikuar disa teste motorike bazike dhe motorike specifike si dhe duke përdorur metoda kuantitative të vërtetojm përzgjedhjen e nxënësve të moshës 13 në disiplinat e vrapimeve në shtigje të shkurta në atletikë.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

H₀₁- Supozojmë se rezultatet e ndryshoreve motorike bazike dhe motorike specifike te nxënësit e moshës 13 +-6 vjeçe nuk do të kenë asimetri të theksuar.

H₀₂- Supozojmë se rezultatet e ndryshoreve motorike bazike dhe motorike specifike te nxënësit e moshës 13 +-6 vjeçe do të kenë koeficiente të korrelacionit statististikisht të rëndësishme.

H₀₃ – Supozojmë se nxënësit e moshës 13 +-6 vjeçe sipas rezultateve në ndryshoret motorike bazike dhe motorike specifike do të ndahen në dy grupe dhe se dallimi në mes këtyre dy grupeve do të jetë statististikisht i rëndësishëm.

4.METODOLOGJIA E PUNËS

Cili do problem antropologjik është i mundur të operacionalizohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë, natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave të proceseve shpesh kërkojnë një qasje multivariante.

Duke marrë këtë parasysh, është e nevojshme të kuptojmë dhe të përdorim disa metoda matematikore dhe statistikore në këtë studim, ku do të përzgjidhen ata për të cilat supozohet se do të ndihmojnë në nxjerrjen e konkluzioneve rreth natyrës së problemit të parashtruar.

Sipas natyrës së kërkimit shkencor, ky studim i përket kategorisë së kërkimeve empirike, ndërsa sipas qëllimit të ndërmarrur paraqet hulumtim aplikativ i cili ka për qëllim të fituarit e njohurive dhe informacioneve të reja të nevojshme për aplikim praktik në fushën e sportit, dhe marrë në tërësi, në praktikat pedagogjike në shkolla.

Në lidhje me njohjen e problemit, ky studim paraqet hulumtim konfirmativ ku në bazë të një problemi të njohur kryhet kontrolli i hipotezave të parashtruara duke përdorur metoda të përshtatshme dhe drafte kërkimore.

Në kushtet e përcaktimit kohor, studimi është i karakterit transversal, dhe konsiston në një matje të vetme të treguesve përkatës të karakteristikave morfologjike, të cilët janë aktiv në sporte përkatëse.

4.1. MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila është nxjerrë mostra për hulumtim për këtë punim është definuar si popullatë e vajzave të moshave të reja për qëllimin e seleksionimit të tyre për sportin e atletikës.

Në këtë punim do të përfshihen gjithsej 50 nxënës të moshës 13 vjeçare të SHFMU nga shkolla "Ismail Luma " Lipjan. Matjet do të ekzekutohen gjatë muajit shkurt në sallën e edukatës fizike në Lipjan.

Kushti i vetëm i përdorur gjatë përcaktimit të mostrës kanë qenë: që nxënësit e moshës së re të jenë të përfshira në orët e rregullta të edukatës fizike dhe në ditën e matjes të jenë të shëndosha (pa grip, ftohje...). Pasi, nxënësit kanë kaluar procedurën paraprake të përzgjedhjes me rastin e

evidentimit, është e natyrshme se do të jenë të aftë në aspektin psikofizik që ti nënshtrohen testeve të tilla për qëllimet e këtij punimi.

4.2. MOSTRA E VARIABLAVE

Në këtë punim do të aplikohen 14 variabla psikomotorike, domethënë variabla psikomotorike për: shpejtësinë, forcën, koordinacionin, fleksibilitetin, dhe ekuilibrin.

4.2.1. Variablat motorike bazike

1. Vrapim 20 m starti i lartë.....	MV20L
2. Kërcim nga vendi në gjatësi	MKGJV
3. Kërcimi nga vendi në lartësi	MKLAV
4. Taping me dorë.....	MTDOR
5. Taping me këmbë	MTKËM
6. Tetëshja me përkulje.....	MTPËR
7. Hapa anash	MHANA
8. Fleksibiliteti përkulje para.....	MFPPA
9. Fleksibiliteti këmbë anash (hapja e këmbëve anash – spaga).....	MFKAS
10. Ekuilibri me një këmbë.....	MEKNK
11. Ekuilibri me dy këmbë.....	MEKDK
12. Ekuilibri me dy këmbë sy mbyllur	MEKSM
13. Hudhja e topit medicinal mbi kokë.....	MHTMK
14. Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit.....	MHTMG

4.2.2 Variablat motorike specifike

15. Vrapim 60 m starti i lartë.....	MV60L
16. Vrapim 100 m starti i lartë.....	MV100L

4.3. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE MOTORIKE BAZIKE

1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 20m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



Foto 1. Vrapimi 20 metra nga starti i lartë

2. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJV

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë-qëndrimi me këmbë të kthyer në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.



Foto 2. Kërcim nga vendi në gjatësi

3. Kërcim nga vendi në lartësi – MKLAV

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari vendoset brinjazi pranë murit Shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: I testuari e ngritë dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , e testuara kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. I testuari bënë disa tentime provuese.



Foto 3. Kërcim nga vendi në lartësi

4. Tapingu me dorë – MTDOR

Instrumentet: Banka, karriga, dy pllaka nga letra e trashë me diametër 20cm në largësi 61 cm nga njëri-tjetri (skajet e brendshme), shirit ngjitës të dukshëm dhe kronometri.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar e kthyer me fytyrë kah matësi i kohës, ku ka qëndruar e ulur në karrige me duar të vendosura mbi bankë (njëra dorë në mes kurse tjetra në pllakën e djathtë). Pas disa tentimeve provuese, i testuari e ka zgjedhë largësinë e duhur nga banka.

Realizimi i detyrës: I testuari qëndron e ulur në karrige dhe vendosë dorën më të dobët në bankë në mes të dy rrathëve, ndërsa dorën tjetër e vendosë mbi pllakë. Detyra është që sa më shpejt ta takoj njëri, pastaj pllakën tjetër, në kohë prej 15 sekondash nga momenti i dhënies së komandës “tash”.

Vlerësimi: Shënohen të gjitha prekjet e rregullta të cilat matësi i numëron brenda 15 sek. Llogaritet çdo takim i dy pllakave (një cikël).

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës.



Foto 4. Tapingu me dorë

5. Tapingu me këmbë – MTKËM

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës i kufizuar në dimensionet 40 X 40 cm me lartësi 36cm., kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar e kthyer me fytyrë kah muri, ku është i shënuar katrori. Pas disa tentimeve provuese, e testuara e ka zgjedhë largësinë e duhur nga katrori i shënuar.

Realizimi i detyrës: Detyra e të testuarit ishte që brenda 15 sek., sa më shpejtë që është e mundur, pa ndërprerje me njërën pastaj këmbën tjetër, të bëjë takime-goditje të dyfishta me pjesën e përparme të shputës. Testi përsëritet tri herë, me pushime të mjaftuara ndërmjet tyre.

Vlerësimi: Llogaritet numri i goditjeve të rregullta me shputë në katrorin e shënuar në kohëzgjatje prej 15 sek.

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra, (i tregohet ngadalë, për goditjet e rregullta dhe ato të parregullta). I testuari bënë disa tentime provuese.



Foto 5. Tapingu me këmbë

6. Tetëshja me përkulje – MTPËR

Instrumentet: Kronometri, dy shtylla dhe një litar 5 m i gjatë. Shtyllat vendosen larg njëra-tjetrës në largësi 4m dhe në to lidhet litari në lartësi të pikës më të lartë të ashtit të legenit të subjektit (lartësia e litarit rregullohet me secilin subjekt veçmas).

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron pranë njërës shtyllë në qëndrim të nisjes së lartë dhe në shenjën “tash”, nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme, duke kaluar nën litar, arrin deri të shtylla tjetër, rrotullohet rreth saj, dhe përsëri vrapon në drejtim të shtyllës tjetër duke u futur nën litar.

Realizimi i detyrës: I testuari nga momenti i dhënies së komandës “tash” ka për detyrë që distancën 4 m ta kalojë 6 herë (ose nga 3 herë duhet të rrotullohet rreth secilës shtyllë).

Vlerësimi: Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzohet gjatë demonstrimit të detyrës.



Foto 6. Tetëshja me përkulje

7. Hapa anash – MHANA

Instrumentet: Kronometri, shirit ngjitës me ngjyrë të dallueshme. Dy pjesë të shiritit të ngjitësit me gjatësi 0.5 m vendosen në dysHEME në largësi 4 m paralel njëra me tjetrën.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron afër vijës së nisjes me këmbë të bashkuara, e kthyer tërthorazi me vijën (drejtimin e lëvizjes).

Realizimi i detyrës: I testuari në shenjën “tash” nisët me shpejtësinë më të madhe të mundshme lëvizë me hapa-anash, duke mos i kryqëzuar këmbët, deri te vija tjetër, dhe kthehet në anën tjetër duke mos e ndërruar pozitën e trupit. Subjekti duhet që largësinë 4m ta kalojë 6 herë.

Vlerësimi: Kronometri ndalet kur subjekti me njërin këmbë arrin te vija e nisjes. Rezultati shënohet në saktësi prej 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: I testuari udhëzimet i mer gjatë demonstrimit të detyrës.



Foto 7. Hapa anash

8. Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) – MFPËPA

Instrumentet: Banak, metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për dërrase të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron mbi ulësen suedeze, me këmbët drejtë, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

- **Realizimi** i detyrës: I testuari në përkulje të thellë dhe këmbët drejtë, në maje të gishtërinjve të të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. I testuari e mbanë pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 8. Përkulje para

9. Fleksibiliteti këmbë anash (hapja e këmbëve anash – spaga) – MFKASP

Instrumentet: Metri milimetrik i plastikës e përforcuar për dysheme me gjatësi 2 m

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në drejtëqëndrim

- **Realizimi** i detyrës: fillon me hapjen e këmbëve anash. Mbrapa të testuarit qëndrojnë dy matës me shiritin metrik dhe atë, njëri afër thembrës së djathtë e tjetri afër thembrës së majtë. Në momentin kur i testuari bënë me shenjë se nuk mundet më shumë të bëjë hapjen, atëherë matësit me shpejtësi tërheqin shiritin metrik dhe tregojnë rezultatin. Pika zero është në mes të njëërës thembër, si dhe pika përfundimtare në mesin e thembrës tjetër.

- **Vlerësimi:** Testi përsëritet dy herë. i testuari e mbanë pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë. Shënohet rezultati i hapjes më të thellë. Saktësia e matjes 0.1 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 9. Fleksibiliteti këmbë anash (hapja e këmbëve anash – spaga)

10. Qëndrimi në një këmbë në bankën për ekuilibër me sy të hapur – MEKSH1

Instrumentet: banka për ekuilibër, kronometri.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari, zbathur vendos njëren këmbë (shputën) sipas dëshirës për së gjati në bankën për drejtpeshim, ndërsa tjetrën në dysheme. Duart janë të mbështetura për beli.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari bartë peshën në këmbën e cila është e vendosur në bankën për drejtpeshim, këmbën tjetër e ngritë nga dyshemeja duke i mos larguar duart nga beli. Detyra është përsëritur tri herë me pauzë të vogël ndërmjet tentimeve.

- **Vlerësimi:** Rezultati shënohet me sekonda prej momentit të ngritjes së këmbës nga dyshemeja e deri tek prekja me këmbë në dysheme.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 10. Qëndrimi në një këmbë në bankën për ekuilibër me sy të hapur – MEKSH1

11. Qëndrimi në dy këmbë në bankën për ekuilibër me sy të hapur – MEKSH2

Instrumentet: Banka për ekuilibër, kronometri.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari zbatuar vendos dy këmbët (shputat) sipas dëshirës për së gjati në bankë. Duart janë të mbështetura për beli.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari bartë peshën në këmbën e cila është e vendosur në bankën për drejtpeshim, këmbën tjetër e ngritë nga dyshemeja dhe e vendosë para tjetrës duke i mos larguar duart nga beli. Detyra është përsëritur tri herë me pauzë të vogël ndërmjet tentimeve.

- **Vlerësimi:** Rezultati shënohet me sekonda prej momentit të ngritjes së këmbës nga dyshemeja e deri tek prekja me këmbë në dysheme.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 11. Qëndrimi në një këmbë në bankën për ekuilibër me sy të hapur – MEKSH2

12. Qëndrimi në dy këmbë në bankën për ekuilibër me sy të mbyllur – MEKSM2

Instrumentet: Banka për ekuilibër, kronometri.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** Pozita fillestare: i testuari, zbathur vendos dy këmbët (shputat) sipas dëshirës për së gjati në bankën. Duart janë të mbështetura për beli.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari bartë peshën në këmbën e cila është e vendosur në bankën për drejtpeshim, këmbën tjetër e ngritë nga dyshemeja dhe e vendosë para tjetrës duke i mos larguar duart nga beli. Detyra është përsëritur tri here me pauzë të vogël ndërmjet tentimeve.

- **Vlerësimi:** Rezultati shënohet me sekonda prej momentit të ngritjes së këmbës nga dyshemeja e deri te prekja me këmbë në dysheme.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 12. Qëndrimi në një këmbë në bankën për ekuilibër me sy të mbyllur – MEKSM2

13. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMKO

Instrumentet: Topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtëqendrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjëruara në nivel të kërdhokullave dhe mbanë topin me dy duart e shtrira lartë mbi kokë.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari nga pozita e drejtëqendrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa më larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 13. Hedhja e topit medicinal mbi kokë – MHTMKO

14. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit – MHTMGJ

Instrumentet: Topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mbanë topin me dy duar në nivel të gjoksit.

- **Realizimi I detyrës:** e testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa më larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

- **Vlerësimi:** Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

- **Udhëzime të testuarit:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



Foto 14. Hedhja e topit medicinal në nivel të gjoksit – MHTMGJ

4.4. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE MOTORIKE SPECIFIKE

15. Vrapim 60 metra nga starti i lartë – MV60L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. Tereni për vrapim

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 60m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



15. Vrapim 60 metra nga starti i lartë

16. Vrapim 100 metra nga starti i lartë – MV100L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek. Tereni për vrapim

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: Pas komandës “gati” nga matësi ndihmës, dhe sinjalit “tash”, i testuari me shpejtësi maksimale vrapon gjatësinë e shtegut 100m.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sek.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. I testuari udhëzohet që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.



16. Vrapim 100 metra nga starti i lartë

4.4 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë që kërkimi shkencor të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komperative e që janë të natyrës së problemit të dhënë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël psikomotorike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrorë themelorë dhe të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetikore (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)
- Koeficienti i variacionit (Kv)

2. Lakorja e distribucionit ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („skjunis”), dhe shkalla e lakimit e majës së kubës së rezultateve të shpërndara (lartësia e distribucionit) përmes koeficientit të sheshtë ("kurtozis").

3. **Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

4. **Analiza faktoriale** qëllimi i kësaj analize faktoriale është që numri i madh i variablave manifeste të lidhura ndërmjet veti të kondenzohet dhe të reduktohet në një numër më të vogël të variablave latente relativisht të pavarura ndërmjet veti të cilat mund të shpjegojnë relacionet ndërmjet vete të grumbullit të analizuar të variablave manifeste. Variablat e ndara latente konsiderohen gjenerator (shkaktar ose burime) të variacioneve dhe kovariancave ndërmjet variablave manifeste.

5. Për përcaktimin e grupit të nxënësve me rezultate më të mira dhe më të dobëta, ndarjen e tyre si dhe dallimin në mes tyre në bazë të variablave motorike bazike dhe motorike specifike do të aplikohet **Analiza taksonome**.

Rezultatet e fituara do të përpunohen me programin statistikor SPSS 17.0.

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI

5.1. ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE BAZIKE DHE SPECIFIKE


Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve psikomotorike, motorike specifike të meshkujve. Mostra ka përfshirë nxënësit e moshës 13 vjeçare të SHFMU nga shkolla "Ismail Luma " Lipjan, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skeëness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet). Interpretimi i rezultateve do të bëhet së bashku me interpretimin e garfikoneve të paraqitura nën tabelë.

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve motorike bazike dhe specifike te nxënësit e moshës 13 vjeçare

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skeëness	Kurtosis	KV
MV20L	50	3.4	4.55	3.79	0.1858	1.116	4.767	4.89
MKGJV	50	151	241	194.02	17.692	0.126	0.511	9.12
MKLAV	50	21	53	32.73	6.987	0.878	0.939	21.35
MTDOR	50	22	45	33.62	5.078	0.294	-0.19	15.11
MTKËM	50	18	33	26.88	3.52	-0.358	-0.066	13.1
MTPËR	50	8.54	13.95	11.24	1.383	0.08	-0.893	12.3
MHANA	50	8.13	13.44	9.55	1.156	1.501	2.314	12.1
